



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 63/16
Prishtinë, më 6.7.2016, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Shqipe Pantina.

Munguan: Jelena Bontić, Bali Muharremi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi- Zv.Ministër i Financave, Ymer Havolli – Kryesues i Bordit Drejtues të FKPK-së, Behxhet Haliti - anëtar i Bordit Drejtues të FKPK-së, Adrian Zalli - Drejtor Menaxhues i FKPK-së.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Sanije Berisha– monitoruese nga OSCE, Taulant Osmani- gazetarë nga BIRN, Arta Rexha - gazetarë nga BIRN.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur të Komisionit, dt. 21.6.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-107 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KfW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Programin “Masat e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari - propozojë që rendi i ditës të plotësohet me dy pika të reja 5 dhe 6, si në vijim: 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe 6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016.

Në bazë të propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, miratoi rendin e ditës me ndryshime. Shtohen dy pika të reja të rendit të ditës me rënditjen 5 dhe 6, si në vijim: 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe 6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur të Komisionit, dt. 21.6.2016;

Kryetari - konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-107 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KfW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Programin “Masat e efijencës së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”;

Kryetari - ky ligj ka për qëllim të ratifikoj marrëveshjen për hua ndërmjet KfW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për Programin “Masat e Efijences së Energjisë në Ndërtesat Publike në Nivel Komunal të Kosovës”.

Agim Krasniqi - theksoi se Qeveria e Kosovës në programin e saj 2015-2018, ka paraparë se zhvillimi i sektorit të energjisë, minierave dhe teknologjisë informuese e komunikuese është një element kyç për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për tëreqjen e investimeve të huaja. Me këtë marrëveshje KfW i jep mundsinë Qeverisë së Kosovës të merr hua shumë prej 2.5 milion euro për me siguri energji më efikase ndërtesave publike në nivel komunal në Kosovë. Huamarrësi, secila prej komunave dhe KfW do të përcaktojnë detaje të vazhdimit të masës së programit që duhet të hyjnë në nivel të secilës komunë, në veçanti në lidhje me kushtet huadhënies së huas si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja me marrëveshje të veçantë. Sipas marrëveshjes huamarrësi duhet të bartë të gjitha taksat dhe pagesat tjera tipike që gjenerohen jashtë Republikës së Gjermanisë, që kanë të bëjnë në lidhje me ekzekutimin e kësaj marrëveshje.

Kryetari - marrëveshja do të fillojë të zbatohet gjatë vitit 2016, kohëzgjatja e kësaj marrëveshje do të jetë 12 vite, deri me 2028. Afati i kthimit të kredisë do të jetë me grejs periudhë në kohëzgjatje prej 3 viteve dhe afat amortizimi për 9.5 vite. Normat e interesit janë të volitshme.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht përkrahu miratimin e Projektligjit dhe nxori këtë

Rekomandim

1. Komisioni i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit nr.05/L-107 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet KfW Frankfurt am Main dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Programin “Masat e efijencës së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë”.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës;

Kryetari – theksoi se ky projektligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen e Kredisë, e nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për Financimin e Projektit për Modernizimin e Shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe huazimin e një shume prej 2.6 milion euro. Për këtë marrëveshje ka pasur diskutime në seancë. Kjo marrëveshje nuk ka ndryshim nga marrëveshja e proceduar në Kuvend vitin e kaluar, ndryshim është projektligji. Përndryshe marrëveshja, përveç shumës së huas, nuk krijon kosto shtesë financiare për institucionet që do ta zbatojnë atë. Shuma e huas do të parashihet në kuadër të planifikimeve vjetore buxhetore të institucioneve përkatëse. Kredia jepet me norme fikse dhe norma e interesit është 0%.

Agim Krasniqi – theksoi se pas kërkeses për struktura financiare nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ne si Ministri e Financave kemi zhvilluar një broshurë për sigurim të fondeve dhe si rezultat i perfundimit të suksesshëm e kemi nënshkruar një marrëveshje financiare e cila siguron një kredi prej 2.6 milion euro, me kushte shumë të volitshme. Duhet të theksohet se marrëveshja financiare bëhet në kuadër të marrëveshjes kornizë për bashkëpunim financiar me Republikën Federale të Austrisë e cila siguron kredi të buta për projekte zhvillimore. Marrëveshja kornizë arrinë një vlerë financiare prej 20 milion euro dhe projekti që keni parajush paraqet marrëveshjen e dytë drejtë shfrytëzimit të kësaj kornize financiare pas asaj që ishte për projektin E-edukimit, që po zbatohet në kuadër të MASHT-it. Kredia do të merret nga Unicredit Bank Austria në vlerë prej 2.6 milion euro dhe tërheqja bëhet në valutën euro, pra nuk ka rrezik valutës. Ka maturitet afatgjatë prej 15 vite e gjysmë, ku 3 vite e gjysmë janë gres periodik dhe 12 vite amortizim. Norma e interesit është 0%, kostoja vjetore prej 1.1% dhe deri në fund të kredisë parashihet shuma prej 273,000 euro.

Safete Hadërgjonaj – ne kemi kaluar njëherë në komisionin një marrëveshje që ka të bëjë me huazimin e mjetet të cilat i dedikohen Qendrës Klinike Universitare, respektivisht kardiologjisë invazive. Mirëpo rreth kësaj marrëveshje kemi pas diskutime dhe debate të ndryshme dhe nuk ka kaluar në Kuvend. Po më intereson me ditë a ka ndryshime prej asaj marrëveshjes së parë që e kemi pasur në shqyrtim apo është marrëveshja identike?

Kryetari - ne e kemi pas një debat rreth kësaj dhe nuk është diskutuar në kushtet e kredisë sepse ato shihen se janë të favorshme. Interesat janë të ndryshme, mirëpo ajo çka është e rëndësishme për mendimin tim janë nevojat për pajisjet e mjeteve të kardiologjisë sepse popullata kosovare më së shumti vuan prej sëmundjeve kardiale. Marrëveshja nuk është rinegociuar, është ajo siq ka qenë me ato kushte. Për neve është me rëndësi të sqarohet se a e ka pëlqimin e kreditdhënësit që kjo të realizohet sipas dinamikës që është paraparë. Nëse arrihen afatet të cilat janë përcaktuara në marrëveshje për neve është e pranueshme dhe procedojmë.

Shqipe Pantina – ju kryetar thatë se norma e interesit është 2%, ndërsa zv.Ministri theksoi se norma e interesit është 0%, kërkohet një sqarim?

Kryetari – sqaroi se mund të kem gabuar në fjalën time paraprake, por norma e interesit në bazë të marrëveshjes është 0%.

Besa Gaxherri – është e vërtetë se kjo marrëveshje ka kaluar në Kuvend dhe fatkeqësisht nuk është aprovuar dhe për mendimin tim ka qenë krejtësisht e paarsyeshme. Ne po e shqyrtojmë të njëjtën

marrëveshje që e kemi kaluar në komision dhe unë konsiderojë se edhe tani do të pajtohemi të gjithë për ta aprovuar. Por na mbetet me punë me grupet parlamentare për të aprovuar një marrëveshje të tillë e cila është e dosmosdoshme dhe me kushte shumë të volitshme, siç u tha me 0% interes.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht përkrahu miratimin e Projektligjit dhe nxori këtë

Rekomandim

1. Komisioni i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit nr.05/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal;

Kryetari - arsyeja pse propozuam që ky projektligj të procedohet me procedurë të përshpejtuar është për faktin se ne jemi në fazën e përgaditjes së buxhetit për vitin e ardhshëm, dhe duhet të krijohet baza ligjore për ndarjen e buxhetit për komunat e vogëla më pak se 22,000 banorë, siç është paraparë me këtë projektligj, gjatë fazës së qarkoreve buxhetore. Ky projektligj është pasojë e vendimit të qeverisë që kemi shqyrtuar dhe përkrahur në komision, por kemi vlerësuar se për tu implementuar duhet ndryshimi i ligjit.

Agim Krasniqi - qështje kryesore e trajtuar me këtë projektligj ka të bëjë me sigurimin e shërbimeve të nivelit minimal për komunat e caktuara. Me këtë projektligj, qeveria planifikon që deri në vitin 2019, nga granti i përgjithshëm të ndajë 2.7% për komunat që kanë më pak se 22,000 banorë. Gjysma e shumës prej 2.7% ndahet në mënyrë fikse për secilën komunë, ndërsa gjysma tjetër proporcionalisht me numrin e popullsisë të komunave përfituese. Përndryshe, qeveria ka aprovuar vendimin për këtë qëllim, i cili është dashur të rregullohet me ligj. Krejt kjo që po bëhet është që t'iu ndihmohet komunave për ti kryer funksionet minimale që i kanë.

Shqipe Pantina – për mua është krejtë e papranushme siç është propozuar në këtë formë projektligji. Ajo që po donë qeveria me të është me i dëmtue qytetarët e komunave që paguajnë taksa, e të cilat taksa duhet të përktheheshin në zhvillim ekonomik, për me i shpërblye komunat e caktuara. Qytetarët nuk përfitojnë nga ky proces, pasi që mjetet do të shkojnë për mallra dhe shërbime. Arsye pse krijohen komunat e reja me iu ofruar shërbime më të mira për qytetarë dhe jo me ngarkue buxheti shtesë sepse krejt qfarë po bëjnë këto komuna po paguajnë disa paga për individ. Mendojë që edhe politikisht organizimi i pushtetit lokal ka qenë paqëndrueshëm dhe i menaxhuar jo mirë nga qeveria. Shtetet që më herët kanë pasur numër të madh të komunash siç është rasti i Shqipërisë, ka bërë një reformë të thellë të pushtetit lokal duke i bashkuar ato komuna. Kurse tek ne akoma po provohet me kriue komuna të reja që as vetën nuk arrijnë me mbajtë. Qeveri do të duhej të bëjë një plan të reformimit komplet të pushtetit vendor dhe me i mbyllë ato komuna që nuk janë të vetëqëndrueshme sepse ka forma tjera që shërbimet që ato munden me u ofruar në mënyrë shumë më efikase, siç është rasti i ofrimit të dokumenteve civile përmes formës online.

Adem Grabovci – ne jemi të obliguar që buxhetin e Kosovës ta përkthej në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Këtu u tha që duhet bërë përpjekje që qytetarëve duhet ofruar shërbime më të mira. Për të ofruar shërbime sa më të mira dhe për të ofruar pushtetin tek qytetarët, normalisht se kërkohen shpenzime dhe ky buxhet duhet të dedikohet edhe për këtë qëllim. Pushteti krijon kushte dhe shërbime si

për qytetarët ashtu edhe për bizneset. Kjo pikë e rendit të ditës ka kaluar në komision dhe mendojë se duhet të përkrahim dhe procedojmë në seancë plenare.

Bardhyl Meta - u tha nga znj. Pantina se po iu bahet padrejtësi qytetarëve të komunave më të mëdha. Kjo është në kundërshtim me politikat dhe programin e partisë së Vetëvendosjes për këtë qështje. Shteti ka për detyrë me i garantue shërbimet publike për të gjithë qytetarët e vendit, pavarësisht se ku jetojnë ata.

Agim Krasniqi - ministria e financave është duke e hartuar strategjinë për financat e pushtetit lokal dhe ligjin për financat e pushtetit lokal, për arsye se kriteret që janë vendosur fillimisht kanë treguar se nuk janë kriteret të drejta. Pozita ekonomike e komunave nuk është e barabartë, prandaj duhet gjejmë kriteret tjera për të përkrahur komunat më pozitive më të pavoritshme ekonomike, sikurse çdo shtet që i ka. Nuk ka të bëjë asgjë me pagat, por sigurohen mallra dhe shërbime, që një pjesë e tyre janë në funksion të ofrimit të shërbimeve të qytetarëve.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, e përkrahu miratimin e Projektligjit në parim, dhe nxori këtë

Rekomandim

1. Komisioni i rekomandojë Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit nr.05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal.

Kryetari - propozojë që Komisioni të kërkojë nga Kuvendi, shmangien e Rregullores së Kuvendit, për shqyrtimin e parë dhe të dytë të Projektligjit nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal.

Në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, dhe nxori këtë

Propozim-Vendim

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9, të Rregullores së Kuvendit, dhe atë si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, bëhet në seancën plenare më 7 korrik 2016.
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, nga Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe Komisionet e përhershme, duhet të përfundojë jo më vonë se deri më 13 korrik 2016.
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-108, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, bëhet në seancën plenare, jo më vonë se deri më 14 korrik 2016.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016;

Agim Krasniqi – sqaroi se Ministria e Financa në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, ka përgatitur Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016. Rishikimi i Buxhetit është bërë në pajtim me marrëveshjen me FMN-së, me përjashtim të një pike, që është pagesa e veteranëve të luftës. Si rezultat i aktivitetit të shtuar ekonomik dhe përmirësimit të vazhdueshëm në administrimin e mbledhjes së të hyrave nga Agjencitë e të Hyrave si dhe formalizimit të agjentëve ekonomik deri në këtë periudhë, realizimi i të hyrave tatimore është më i lartë për 13.2%, në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të hyrat e përgjithshme janë rritur për 33 milion euro. Kemi bërë kursime në mallra dhe shërbime prej 5 milion euro dhe në projekte kapitale prej 27 milion euro. Kursimi në projektet kapitale nuk ka prekur projektet që janë në vazhdim të realizimit, vetëm se janë prekur shumat për ato projekte që nuk kanë pasur zotim dhe shpenzim të mjeteve sipas dinamikës që kanë planifikuar organizatat buxhetore.

Në tërësi të hyrat e përgjithshme janë 1 miliard e 635 milion euro dhe paraqet një rritje prej 11%, krahasur me realizimin e vitit 2015 ose rritje prej 2.1%, krahasur me buxhetin fillestar 2016. Të hyrat nga ATK janë 12.7% ,krahasur me vitin 2015, ndërsa 1.5% krahasuar me buxhetin fillestar. Të hyrat nga doganat janë prej 3.5%, në raport me buxhetin fillestar dhe priten rritje prej 9.3%. Shpenzimet janë planifikuar në total 1 miliard e 735 milion euro. Prej tyre shpenzime rrjedhëse janë 1 miliard e 221 milion euro, ndërsa shpenzime kapitale 502 milion euro. Në kuadër të shpenzimeve janë ndarë mjete shtesë për veteranët e luftës për 7 milion euro, për subvencionimin e RTK-së 4.8 milion euro, për financimin e Rruës 6, 40 milion euro, për obligimet e ministrive të linjës me komunat veriore 2.7 milion euro, janë bërë rialokimet e nevojshme në mes ministrive dhe komunave në shumë prej 6.7 milion euro. Si dhe është plotësuar rezervë prej 4 milion eurove. Në rast të paraqitjes së ndonjë nevoje në vazhdim, ne kemi mundësi të bëjmë rregullimeve të buxhetit në tetor.

Shqipe Pantina – duke pasur parasysh kohën e shkurtër të pranimit të materialit, është e pamundur që brenda një ore me i pa ndryshimet. Nuk po mund ti gjejë të paktën tabelat, që sqarojnë se si ka qenë buxheti aktual dhe cilat janë ndryshimet. Kështu që për të parë ndryshimet duhet analizuar krejt dokumentin dhe të bëhen krahasime me buxhetin fillestar në fuqi. Nuk po e kuptojmë këtë nguti për procedimin e rishikimit të buxhetit, ose nëse është e nevojshme atëherë pse nuk është proceduar më herët në Kuvend. Është dashur të paktën të kemi një kolonë që tregon buxhetin aktual dhe ndryshimet e propozuara. Ne kemi pranuar një kërkesë për mjete shtesë nga Posta, nuk e dij a e keni adresuar me buxhet apo ne duhet ta trajtojmë gjatë amendamentimit?

Agim Krasniqi – për shkak të raporteve dhe negociatave me minisionin e FMN-së jemi vonuar në përocedimin e rishikimit në Kuvend. Në tabelën 1 vërehet buxheti fillestar dhe ndryshimet e propozuara. Po ashtu edhe në tabelat tjera janë paraqitura buxheti aktual dhe ndryshimet që i kemi bërë me rishikim.

Safete Hadërgjonaj – rishikimi i buxhetit zakonisht bëhet për rirregullime të brendshme të buxhetit dhe shifet se ka lëvizje të buxhetit. Ju si zv. ministër i shpjeguat se ka ndryshime tek të hyrat si rezultat i rrijës së të hyrave tatimore dhe tek shpenzimet po ashtu. Ajo që është e rëndësishme për komisionin është nevoja me ditë rreth negociatave që keni zhvilluar me FMN. Sa i përket fondit të veteranëve të luftës, duhet të rishikohet dhe të vërtetohen të gjitha ata veteranë që sigurojnë të hyra nga burimet tjera, në mënyrë që mos të pësojnë veteranët tjerë që nuk pranojnë të hyra tjera. Pra mos të rrezikohet pagesa e këtyre kategorive të veteranëve që nuk kanë burimet të tjera të të hyrave.

Ajo që mua më shqetëson gjatë shqyrtimit ë buxheti është planifikimi jo i mirë i buxhetit që po sjell vështërsi në realizimin e tij në organizat buxhetore dhe është sugjerim që duhet të del edhe nga ministria e financave sidomos për komunat që ti kenë parasysh të gjeturat dhe rekomandimet edhe të auditorit të

përgjithshëm dhe mos të bëjnë planifikime jo të rregullta, në mënyrë që pastaj mos të bëhen shkelje gjatë ekzekutimit të shpenzimeve.

Agim Krasniqi – siq e theksova ne kemi bërë ndarjen e mjeteve për pagesën e veteranëve të luftës që besojmë që deri në tetor janë të mjaftueshme, ndërsa deri në këtë kohë bashkarisht duhet të gjindet një zgjidhje për këtë kategori. Sa i përket planifikimit të buxhetit pajtohem me shqetësimet e ngritura por do ta shqyrtojmë bashkarisht gjatë përgaditjes së buxhetit të ardhshëm që të eliminohen problemet që janë shfaqur më herët.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, e përkrahu miratimin e Projektligjit në parim, dhe nxori këtë

Rekomandim

1. Komisioni i rekomandojë Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016.

Kryetari - propozojë që Komisioni të kërkojë nga Kuvendi, shmangien e Rregullores së Kuvendit, për shqyrtimin e parë dhe të dytë të Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016.

Në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë

Propozim-Vendim

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016, të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit, dhe atë si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016, bëhet në seancën plenare më 7 korrik 2016.
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe Komisionet e përhershme, duhet të përfundojë jo më vonë se deri më 13 korrik 2016.
3. Shqyrtimi i dytë Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016, bëhet në seancën plenare jo më vonë se deri më 14 korrik 2016.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetari – theksoi se Komisioni me datë 17.5.2016 e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Komisioni funksional e ka proceduar edhe një herë projektligjin dhe ka propozuar një amendament me të cilin ndryshohet neni 11 i projektligjit, respektivisht neni 18 i ligji bazik. Paragrafi 1 është siç ka qenë propozuar edhe në raportin e parë të komisionit funksional, ndërkaq ndryshimi është bërë në paragrafin 2, nuk krijon kosto shtesë buxhetore. Prandaj propozojë që komisioni të rekomandojë se projektligji dhe amendamenti i propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe amendamenti i propozuar nga nga Komisioni Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015

Kryetari – theksoi se raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015 është dorëzuar në Kuvend në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës. Raporti ofron informata për organizatën dhe financimin. Për veç kësaj raporti përmban të dhëna për aktivitetet, investimet e kursimeve pensionale, kontribumi dhe pensionimet. Po ashtu, në raport përfshihet korniza Ligjore, operacionet dhe mjetet pensionale.

Ymer Havolli – theksoi se edhe viti 2015 ka pasur një kthim pozitiv prej 29.6 milion euro ose rritje e qmimit prej 2.3%. Në këtë drejtim kanë ndikuar 94% e investimeve në tregjet globale dhe 4 % në tregjet e letrave me vlerë në Kosovë ,dhe këtë aspekt rreth 96 milion euro janë investuar në letrat me vlerë të qeverisë, ndërsa 6 milion euro në bankat komerciale. Për pesë vitet e fundit kthimi bruto nga investimet është rreth 225 milion euro apo kthim neto prej 28%. Në vitin e kaluar, Fondi kishte nën menaxhim 1 miliard e 230 milion euro dhe 142 milion euro më shumë se periudha paraprake apo 13%. Vlera e mjeteve të arkëtuara për kontribute ishte 138 milion euro. Kemi regjistruar 11582 kontribues aktiv në krahasimin me vitin e 2014. Gjatë vitit janë pensionuar 4438, të cilët kanë tërhequr 19.3 milion euro. Fondi ka marrë opinion të pastërt nga Auditori për pasqyrat financiare që janë në harmoni me standardet e raportimit financiare.

Besa Gaxherri - ju përgëzojë për një raport gjithpërfshirës dhe të përgaditur profesionalisht. Trendi i kthimit të mjeteve është pozitiv që duhet vlerësuar. Ajo që vlerësojë pozitive janë propozimet e Fondit për amendamentimin e ligjit aktual dhe ne duhet të shqyrtojmë këto propozime që të plotësojmë dhe ndryshojmë ligjin që ju me operue sa më mirë dhe kontribuesit me përfitue nga këto ndryshime. Raporti i auditimit të pavarur jep opinion pozitiv që na jep siguri në qështjen e shpenzimeve të mjeteve. Sa i përket investimeve mjeteve shifet se ka tërheqje nga disa aset menaxher, pra ka lëvizje të mjeteve,

përkundër performancës pozitive, kërkohet një sqarim? Ndërsa sa i përket riskut është vlerësuar se mjetet aktualisht nuk kanë risk dhe është për tu vlerësuar dhe urojë me pas një trend të tillë në vazhdim.

Shqipe Pantina – vlerësojë raportin përmbajtësor. Por unë po ngrisë dy qështje që janë shqetësime edhe të qytetarëve. Njërin e keni adresuar por nuk po e shoh tek lista e rekomandimeve, e që është ndalesa në tatimin në të hyra. Pse nuk e keni paraqitur tek lista rekomandimeve këtë qështje? E dyta shumë qytetarë janë ankuar se munden me i tërheq mjetet e tyre vetëm tek Banka Teb dhe qytetarët po pësojnë nga pagesa prej 1.5 euro e tërheqjes së mjeteve të tyre. Nuk e di a duhet me qenë vendim i Bordit për t'iu paguar mjetet aty ku i posedojnë apo duhet bërë ndonjë ndryshim ligjor në këtë drejtim?

Ymer Havolli – përkundër krizave në tregjet financiare që ndikohen edhe nga ndikimet politike siç ishte edhe Brexit-i, përmes një strategjie të aplikuar nga Bordi kemi arritur që jo të kemi rënie të vlerës së aksioneve por rritjes siç ishte 33 milion euro vitin e kaluar.

Adrian Zalli – sa i përket tërheqjes së mjeteve nga aset menaxherët e caktuar që u bë pyetje, arsyeja është për shkak se kemi parë se afërsia menaxhuese është më e dobët se e të tjerëve. Përveç performancës ka pasur ndryshime në menaxhment në këtë aset menaxher. Po ashtu rol luan edhe rejtingu i investimit dhe kthimit të mjeteve. Kjo është diçka që ndodh në politikën e investimin e mjeteve në tregjet financiare.

Behxhet Haliti – sa i përket e tatimit në burim, në bazë të ligjit të ardhurat tatimohen në momentin kur ato tërhiqen. Çdo i punësuar për pagesën e kontributit pensional nuk paguan tatim dhe në momentin kur i tërheq mjetet bëhet llogaritja dhe pagesa e tatimit në burim, pra qoftë edhe për pagesën në emër të pensionit. Kjo është një qështje e rregulluar ligjore dhe është praktikë në të gjitha vendet. Sa i përket tërheqjes së mjeteve në faza është fakt që edhe Fondi ka pasur angazhim që me rritur nurmin e bankave që ofrojnë këtë shërbim. Deri me vitin e kaluar këtë shërbim ka ofruar vetëm një Bankë në bazë të shprehjes së interesit dhe këtë vit janë ofruar edhe tri banka tjera dhe procedurat kanë filluar për ofrimin e këtij shërbimi dhe qytetarët kanë mundësi me i tërheq mjetet në katër banka.

Ymer Havolli – ne bëjmë ftesë për të gjitha bankat për ofrimin e shërbimeve dhe varet nga interesi dhe kushtet që ofrojnë ato banka për të kryer shërbimet për pensionistët.

Kryetari – aktualisht pensionisti mund ta merr pensionin vetëm përmes bankës. E kemi diskutuar si mundësi që pensionet të shërndahen apo të merren përmes Postës dhe a keni zhvilluar ndonjë diskutim me Postën në këtë drejtim?

Adrian Zalli – me Postën nuk kemi pasur diskutime për këtë qështje, mirëpo Posta nuk ka shprehur interesim për këtë shërbim. Por ne prej bankave për këtë shërbim që ofrojnë kemi kërkuar të ofrojnë një kamatë që janë shuma relativisht të mëdha, duke pasur parasysh që këto mjete mbesin për një periudhë në bankë. Posta nuk e di a mund të ofrojë kamatën, ndoshta distribuimin e shumës së pensioneve mund ta bëjë. Ndërsa, sa i përket marrëdhënieve me Postën ne bëjmë distribuimin e pasqyrave financiare përmes Postës.

Safete Hadërgjonaj – jam befasuar për të mirë me pasqyrën e të dhënave të prezantuara në raportin tuaj. Kemi mundësi me pa të dhënat edhe për punën tonë në Kuvend dhe mëtuje spese kemi përmbledhje të treguesve të ndryshëm që i kemi parë edhe në raporte tjera, por këtu janë më të besueshme, e sidomos tek qështja e të punësuarve. Po ashtu e kemi një pasqyrë shumë të mirë të të dhënave për mënyrën operacionale por edhe të dhënave të investimeve të mjeteve. Ajo që më ka bërë përshtypje tek numri i llogarimbajtëse dhe gjinia demografia e kontribuesve që është një raport 70 me 30, që është një pasqyrë jo shumë e mirë për neve që e shikojmë nga një kënd tjetër. Një qështje që e kemi diskutuar edhe në të

kaluarën është problemi me barazimin e kontributeve apo tek shifrat që nuk janë të alokuara. Po shofim se ka rënie apo lëvizje në vitin 2015, mirëpo ende është problem kjo që është. A keni zhvilluar takime apo e keni krijuar ekipe të përbashkëta me ATK-në, për të identifikuar pronarët e mjeteve të paalokuara, në mënyrë që të gjindet një zgjidhje dhe kontribuesit të mos dëmtohen, nga mospasja në llogari të kontributeve pensionale të tyre?

Ymer Havolli – mjetet e paalokuara e kanë historikun e themelimit të Fondit dhe ka pasur mjete që nuk iu është ditur pronari i tyre. Kompanitë e kanë sjellur një shumë të kontributeve, por jo edhe listën emërore se ku duhet të shkojnë mjetet pensionale. Këto mjete invesohen por fatkeqësia është se nuk iu dihet pronari. Ne kemi ndërmarrë një fushatë, qoftë edhe përmes mediave që të identifikohen pronarët e këtyre mjeteve. Kemi diskutuar edhe me BQK-në dhe Ministrinë e Financave, për të shikuar zgjidhjen e këtij problemi.

Shqipe Pantina - në lidhje me mjetet e paalokuara unë jam personalisht viktimë e kësaj. Nëse kompanitë nuk arrijnë me dëshmue pronarin, qoftë edhe për shkak të falimentimit të tyre, a ka mundësi që qytetarët përmes kontratës me dëshmue se ata janë kontribues të mjeteve të paalokuara?

Adrian Zalli – sqaroi se shumica e fondeve të paalokuara janë për shkak se kompanitë kanë falimentuar dhe kontabilisti nuk i ka dorëzuar listat me kohë dhe të hollat kanë mbetur në Fond. Dëshmia e mjeteve duhet të bëhet përmes ATK-së, që e njofton Fondin dhe pastaj mjetet alokohen në llogarinë përkatëse. Kjo që është do të mund të rregullohen me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

1. Komisioni i rekomandojë Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015.

Mbledhja përfundoi në ora 14:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani